



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **LICENCË PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE**

**DHËNË :**

**MCM COMMODITIES Sh.P.K.**

**Numri i Licencës: ZRRE/Li\_71/21**

**Prishtinë, 31 mars 2022**



## PËRMBAJTJA

|         |  |    |
|---------|--|----|
| Neni 1  | Qëllimi .....  | 3  |
| Neni 2  | Përkufizimet .....   | 3  |
| Neni 3  | Të drejtat dhe detyrimet.....  | 4  |
| Neni 4  | Llogaritë e Ndara për Aktivitetet e Licencuara .....   | 4  |
| Neni 5  | Çmimi i Furnizimit dhe Ndalimi i Ndër- subvencioneve .....   | 5  |
| Neni 6  | Ndalimi i diskriminimit .....  | 6  |
| Neni 7  | Ndalimi i abuzimit të pozitës dominuese .....  | 6  |
| Neni 8  | Ndërrimi i Furnizuesit .....   | 6  |
| Neni 9  | Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ..... | 7  |
| Neni 10 | Detyrimet e të Licencuarit .....   | 7  |
| Neni 11 | Mbrojtja e Konsumatorëve .....   | 7  |
| Neni 12 | Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes.....   | 8  |
| Neni 13 | Rregullat e Tregut .....   | 9  |
| Neni 14 | Shëndeti dhe Siguria .....   | 9  |
| Neni 15 | Puna .....   | 9  |
| Neni 16 | Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....   | 9  |
| Neni 17 | Obligimi i Shërbimit Publik.....   | 10 |
| Neni 18 | Blerja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë .....   | 10 |
| Neni 19 | Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.....  | 10 |
| Neni 20 | Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit.....  | 10 |
| Neni 21 | Vazhdimi,Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....   | 11 |
| Neni 22 | Taksat.....  | 11 |
| Neni 23 | Masat Administrative dhe Gjobat.....   | 11 |
| Neni 24 | Zgjidhja e Kontesteve.....   | 12 |
| Neni 25 | Hyrja në fuqi.....   | 12 |



## Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE** (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 28 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Ligjin për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) nëpërmjet kësaj, në seancën e datës **31 mars 2022** i lëshon Licencën për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, me numër licence **ZRRE/Li\_71/21**, Adresa: **Rr. Nëna Terezë, Nr.1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës**, (në tekstin e mëtejshëm "i licencuari").

## Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
  - a) **Vit financiar** - është periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
  - b) **Rregulla të Tregut** - norma që rregullojnë tregtimin me energji elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve të tregut të energjisë, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, me qëllim të mbajtjes së balancit fizik në treg.
  - c) **Përgjegjësi Balancimi** - ka kuptimin e njëjtë si në rregullat e tregut të miratuara nga Rregullatori.
  - d) **Konsumator fundor** - ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike.
  - e) **Person i ndërlidhur** - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, siç është përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në fuqi.
  - f) **Legjislacion** - nënkupton Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L-081, Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L-085) dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
  - g) **Furnizues i Mundësisë së Fundit** - ka kuptimin e përshkruar në Nenin 3, paragrafi 1.19 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
  - h) **Konsumatorët e Shërbimit Universal** - do të thotë çdo konsumator që ka të drejtën e shërbimit universal të furnizimit, sipas Nenit 3, paragrafi 1.72 i Ligjit për Energjinë Elektrike.



2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

### **Neni 3**

#### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. I licencuari do të gëzojë të drejtat dhe do të marr përsipër përgjegjësitë e caktuara në ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet në fuqi.
2. I Licencuari ka të drejtë të:
  - 2.1. shes energji elektrike tek Konsumatorët Fundor, në përputhje me këtë licencë;
  - 2.2. blej energji elektrike në tregjet me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike me çmime të parregulluara, në përputhje me Nenin 33.5 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
  - 2.3. ri-shes me çmime të negociuara lirshëm tepricën e kapaciteteve dhe energjisë elektrike tek kompanitë tjera të licencuara të energjisë elektrike.
  - 2.4. importoj dhe eksportoj kapacitete dhe energji elektrike në përputhje me rregullat në fuqi;
  - 2.5. faturoj dhe inkasoj të hyra nga konsumatorët e vet në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
4. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me dispozitat dhe kushtet e specifikuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet e tjera në fuqi.

### **Neni 4**

#### **Llogaritë e Ndara për Aktivitetet e Licencuara**

1. I Licencuari do të përgatis Pasqyrat Financiare vjetore, në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga Rregullatori dhe do t'i dorëzoj Rregullatorit një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme për aktivitetet e furnizuesit duhet të jenë të ndara nga llogaritë e brendshme të aktiviteteve të tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill të vitit aktual, për dorëzim të këtyre pasqyrave.
2. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.



3. Në kontabilitetin e tij të brendshëm, i Licencuari do të mbaj llogari të ndara për furnizimin e energjisë elektrike tek konsumatorët e shërbimit universal.
4. Nëse kërkohet nga Rregullatori kohë pas kohe, i Licencuari duhet të dorëzoj të gjitha llogaritë në formën dhe datën e specifikuar nga Rregullatori. Kontabiliteti rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimet e Rregullatorit lidhur me raportimin e pasqyrave Rregullative, dhe ndër të tjera, mund të specifikoj:
  - 4.1. formën e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë ngarkuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të Furnizimit Publik dhe aktiviteteve të tjera;
  - 4.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve nga aktivitetet e specifikuara;
  - 4.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
5. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk duhet, sa i përket gjendjeve llogaritë në lidhje me vitin financiar, të ndryshoj bazat e ngarkesave, ndarjen ose alokimin nga ato të aplikuar në vitet e mëhershme financiare, përveç nëse Rregullatori ka lëshuar më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
6. Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga Rregullatori, dhe legjislacioni në fuqi.

## Neni 5

### Çmimi i Furnizimit dhe Ndalimi i Ndër- subvencioneve

1. Të gjitha çmimet e furnizimit të energjisë elektrike të ngarkuara tek konsumatorët fundor nga i licencuari duhet të vendosen lirshëm.
2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike, i Licencuari duhet të sigurohet që çmimet e furnizimit nuk do të rriten apo të ulen si rezultat i pranimit apo dhënies së ndonjë ndër-subvencioni (direkt apo të tërthortë) nga apo në emër të ndonjë aktiviteti të tillë të të licencuarit apo ndonjë entiteti vartës, korporatë ose ndonjë personi tjetër juridik apo fizik.
3. I Licencuari poashtu duhet të sigurohet që çmimet e ngarkuara nuk do të përfshijnë ndonjë ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) ndërmjet konsumatorëve të shërbimit



universal të furnizimit dhe konsumatorëve të tjerë fundor, e as ndërmjet ndonjë prej konsumatorëve individualë apo kategorive të konsumatorëve, përveç në nivelin e miratuar nga Rregullatori.

#### **Neni 6 Ndalimi i diskriminimit**

Gjatë vendosjes së çmimeve që do t'u ngarkohen konsumatorëve për energjinë e furnizuar, i Licencuari nuk duhet të ketë preferenca ndaj ndonjë konsumatori apo kategorie të konsumatorëve, nuk do të ushtroj diskriminim ndaj ndonjë konsumatori apo kategorie të konsumatorëve dhe nuk do të vendos kushte të padrejta të furnizimit të cilat janë të vështira për t'u përmbushur.

#### **Neni 7 Ndalimi i abuzimit të pozitës dominuese**

1. Të Licencuarit i ndalohet abuzimi i pozitës dominuese, siç përcaktohet në Nenin 23 të Ligjit për energjinë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
2. Nëse ka dyshim për abuzim nga i Licencuari, sipas paragrafit 1 të këtij Neni, Rregullatori do të njoftoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe mund të rezultoj në masa administrative dhe gjopa që do t'i ngarkohen të Licencuarit, siç përcaktohet në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

#### **Neni 8 Ndërrimi i Furnizuesit**

1. I Licencuari duhet të ndërmarr të gjitha masat për trajnimin e punëtorëve lidhur me aplikimin e rregullave dhe procedurave për ndërrim të furnizuesit dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve për ndërrim të furnizuesit.
2. I Licencuari duhet të bashkëpunoj plotësisht me ndërmarrjet e tjera të licencuara gjatë procesit të ndërrimit të furnizuesit dhe i ndalohet të Licencuarit që të shtyj apo pengoj këtë proces pa arsye.
3. Kur një konsumator fundor që nuk është konsumator i Shërbimit Universal të Furnizimit tashmë ka ushtruar të drejtën e tij për ndërrim të furnizuesit dhe ka përfunduar kontratën e furnizimit me energji elektrike nga i Licencuari, dhe më pas ka kërkuar kontratë të re të furnizimit me të Licencuarin, një kërkesë e tillë nuk duhet t'i refuzohet nga i Licencuari pa arsye.
4. Kur një konsumator fundor i cili është edhe konsumator i Shërbimit Universal të Furnizimit është shkyçur dhe ka përfunduar kontratën e tij të furnizimit me të Licencuarin, dhe më pas ka kërkuar një kontratë të re furnizimi me të Licencuarin, një kërkesë e tillë nuk duhet t'i refuzohet nga i Licencuari dhe kjo kërkesë duhet të trajtohet nga i Licencuari në mënyrë



të shpejtë dhe të plote, sikur të jetë kërkesë nga çdo konsumator tjetër i Shërbimit Universal të Furnizimit.

#### **Neni 9**

#### **Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit, Kodeve të Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari duhet të ketë përgjegjësi balancimi dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura për të parashikuar saktë kërkesën e tij të ardhshme dhe që të ofrojë në mënyrë të shpejtë, të plotë dhe të saktë të gjitha informatat e kërkuara për t'iu dorëzuar ndonjë ndërmarrjeje të energjisë, në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara nga Rregullatori.

#### **Neni 10**

#### **Detyrimet e të Licencuarit**

1. Rregullatori, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe tregut të energjisë, ka të drejtën t'i vendos të Licencuarit një obligim për të ofruar Garanci Financiare, në baza të përkohshme apo të përhershme, në përputhje me Nenin 8 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. I licencuari do të kryejë aktivitetet e tij të licencuara në një mënyrë efektive, ekonomike dhe të koordinuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. I Licencuari do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për implementimin e obligimeve të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e tjera të kësaj licence dhe marrëveshjet e arritura me palët e tjera, duke përfshirë edhe ndonjë Marrëveshje për Blerje të Energjisë.

#### **Neni 11**

#### **Mbrojtja e Konsumatorëve**

1. I Licencuari do të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me shërbimet e energjisë elektrike.
2. I Licencuari është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve të vet, duke bërë adresimin e ankesave në lidhje me çdo veprim, mospërfillje ose shkelje të bërë nga vet furnizuesi apo operatori i sistemit, si dhe duke bërë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur këto ankesa, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.



3. I Licencuari duhet të siguroj të paktën një punëtor gjatë orëve të punës, që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të konsumatorëve.
4. Zyrtarët e të Licencuarit, që janë përgjegjës për pranimin e thirrjeve telefonike dhe pranimin e konsumatorëve në zyrë, duhet të jenë të kualifikuar dhe të udhëzuar siç duhet për mënyrën e trajtimit të shpejtë dhe korrekt të çështjeve të ankesave/kontesteve dhe kërkesave për shërbim, apo udhëzimin e tyre në departamentin përkatës.
5. I Licencuari është i detyruar t'iu përgjigjet të gjitha ankesave të konsumatorëve në mënyrë efikase dhe të drejtë, në pajtim me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
6. I Licencuari do të informoj konsumatorët e tij për adresën postare, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike të shërbimit të informatave, që i ka themeluar me qëllim të pranimit të ankesave të tyre apo raportimit të ndonjë incidenti.
7. I Licencuari është i obliguar që t'i informoj konsumatorët e tij së paku pesëmbëdhjetë ditë para ndonjë ndryshimi në kontratat e tyre të furnizimit apo ndryshim në çmime, dhe poashtu t'i njoftoj ata për të drejtën e tyre për përfundim të kontratës, nëse ata nuk i pranojnë kushtet e reja të furnizimit.
8. I Licencuari duhet të siguroj një qasje të lehtë të pakove të ndryshme të shërbimeve tek konsumatorët e tij fundor.
9. I Licencuari është i obliguar që në faqen e tij elektronike të ketë një llogaritës për të llogaritur koston e energjisë elektrike.
10. I Licencuari duhet të u dërgoj Konsumatorëve Fundor njoftimin për skadim të kontratës, së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të saj.
11. I Licencuari është i obliguar t'i informoj konsumatorët e tij për procesin e ndërrimit të furnizuesit.

## Neni 12

### Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuara nga Rregullatori.
2. Kur Rregullatori kërkon apo kur i Licencuari e konsideron të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtoj standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes brenda afatit të përcaktuar nga Rregullatori.
3. I Licencuari do të zbatojë standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë Rregullatorit për aprovim procedurën e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë të furnizimit





dhe shërbimit. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.

4. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator çdo vit raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
5. I Licencuari do të publikoj Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit, ashtu siç kërkohen nga Rregullatori, lidhur me përmbushjen ose mos përmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

### **Neni 13 Rregullat e Tregut**

I Licencuari do të veproj në përputhje me Rregullat e zbatueshme të Tregut.

### **Neni 14 Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do të ndërmarr të gjithë veprimet e nevojshme për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontrole (auditime) teknike dhe të sigurisë në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgoj në Rregullator, sa herë që kjo kërkohet nga Rregullatori.

### **Neni 15 Puna**

Sa i përket marrëdhënies në punë dhe sigurisë në punë, I Licencuari do të veproj në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

### **Neni 16 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftoj Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa Rregullatori nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për çdo ndryshim në strukturën organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet Rregullatorit jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.



### **Neni 17** **Obligimi i Shërbimit Publik**

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga Rregullatori, sipas Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Obligimet e tilla të vendosura do të bëhen pjesë përbërese e kësaj Licence.

### **Neni 18** **Blerja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë**

I Licencuari do të përformoj çdo obligim lidhur me marrjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), që mund të vendoset mbi të si rezultat i hartimit, apo aprovimit nga Rregullatori.

### **Neni 19** **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit**

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset atij nga Rregullatori, duke përfshirë obligimin e furnizuesit të mundësisë së fundit, në përputhje me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

### **Neni 20** **Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit**

1. I Licencuari do t'i dorëzoj Rregullatorit informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t'i konsiderojë të përshtatshme.
2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator raporte mbi veprimtarinë e Furnizimit me energji elektrike, si dhe pajtueshmërinë me kushtet Licencës, në pajtim me Doracakun e Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, si dhe kërkesave të Rregullatorit.
3. Nëse i Licencuari, në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidenciale, ai ka për obligim që të shënoj informatën e tillë si konfidenciale dhe të arsyetoj kërkesën e tij në Rregullator. Rregullatori do të shqyrtoj kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. Rregullatori ka të drejtë të kërkoj nga i Licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari do të emërojë një person përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut si dhe Operatorin e Sistemit të Shprëndarjes. Adresa, numri i telefonit, faksit apo adresa elektronike e



personit të tillë do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Shprëndarjes,

6. I Licencuari do t'i dërgoj Rregullatorit çdo kopje të kontratave të nënshkruara për furnizim, marrëveshjet bilaterale për blerje të energjisë elektrike.
7. I Licencuari do t'i dërgoj Rregullatorit detajet mbi çdo ndryshim të informatave të dërguara gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

**"Informacion"** - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshij çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

#### Neni 21

##### Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. Rregullatori mund të vazhdoj, modifikoj, pezulloj dhe ndërpres këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. Rregullatori mund të transferoj këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

#### Neni 22

##### Taksat

I Licencuari do t'i paguaj Rregullatorit çdo taksë fillestare apo vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga Rregullatori.

#### Neni 23

##### Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga Rregullatori, Nenet dhe kushtet e kësaj Licence, apo instruksionet e dhëna të Licencuarit nga ana e Rregullatorit, Rregullatori ka kompetenca t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.



3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

#### Neni 24 Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet sipas Rregullës për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës, si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve në fuqi, mund të kontestohen nga i Licencuari në Gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 25 Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 12, Nenin 28 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë me numër **ZRRE/Li\_71/21** i lëshohet ndërmarrjes **MCM COMMODITIES SH.P.K.** për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe hynë në fuqi me datë **31.03.2022**.
2. Kjo Licencë do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë pesë **(5) vjeçare**, deri më **30.03.2027** me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës dhe plotëson kushtet për vazhdim licence, në pajtim me Nenin 32 paragrafin 2, nënparagrafin 2.4 dhe paragrafin 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
3. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **MCM COMMODITIES Sh.P.K.** të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshojë nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Nënshkruar nga Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit:

Nënshkruar më: 31.03.2022



Fundi i dokumentit